




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR



Nr. 75, datë 10.9.2021

PËR

NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR HARTIMIN E PROJEKTPLANIT TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA PËRMBYTJET PËR ZONAT KU EKZISTON RREZIKU POTENCIAL NGA PËRMBYTJET OSE KA GJASA TË NDODHIN PËRMBYTJE, DRIN-BUNË 4, 5 DHE 6, TË SHPALLURA ME VENDIMIN NR.1, DATË 15.6.2021, TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT (TERRITORI I NJËSIVE ADMINISTRATIVE SHKODËR, ANA E MALIT, BËRDICË, DAJÇ, GURI I ZI, RRETHINAT DHE VELIPOJË TË BASHKISË SHKODËR DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE BUSHAT TË BASHKISË VAU I DEJËS)

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e projektplanit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6, të shpallura me vendimin nr.1, datë 15.6.2021, të Këshillit Kombëtar të Ujit (territori i njësive administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të Bashkisë Shkodër dhe Njësinë Administrative Bushat të Bashkisë Vau i Dejës).
2. Objekti i veprimtarisë së grupit ndërinstitucional të punës është hartimi i projektplanit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6, të shpallura me vendimin nr.1, datë 15.6.2021, të Këshillit Kombëtar të Ujit (territori i njësive administrative Shkodër, Ana e Malit,

Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë, të Bashkisë Shkodër dhe Njësinë Administrative Bushat të Bashkisë Vau i Dejës).

3. Grupi ndërinstitucional i punës të përbëhet nga përfaqësues të:

- Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore;
- Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
- Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit;
- Agjencisë së Zhvillimit të Territorit;
- Autoritetit Rrugor Shqiptar;
- Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve;
- Agjencisë Kombëtare të Pyjeve;
- Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
- Shërbimit Gjeologjik Shqiptar;
- Institutit të Shëndetit Publik;
- Institutit të Statistikave;
- Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë;
- Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër;
- Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Shkodër;
- Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

4. Grupi ndërinstitucional i punës të drejtohet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe të mbështetet nga ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të kontraktuar nga projekti “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimi i rrezikut të përmytjeve në Ballkanin Perëndimor (CCA WB)”, zbatuar nga GIZ, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

5. Gjatë hartimit të projektplanit të menaxhimit të rrezikut nga përmytjet për zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmytjet ose ka gjasa të ndodhin përmytje, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në mbështetje të grupit ndërinstitucional të punës, duhet të konsultohet dhe të kërkojë mbështetje nga Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vau i Dejës, si edhe duhet të bashkëpunojë me departamentet e inxhinierisë së mjedisit dhe hidroteknikës e hidraulikës, të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, me Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, të Universitetit Bujqësor të Tiranës,

me Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Shkodrës, shoqërinë civile, ekspertët e jashtëm apo përfaqësues të organizatave ndërkombëtare.

6. Organizimi i mbledhjeve të grupit ndërinstitucional të punës të bëhet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Në mbledhjen e parë, grupi të miratojë kalendarin e punës për të gjithë periudhën e funksionimit të tij. Mbledhjet të zhvillohen të paktën një herë në muaj. Komentet dhe kontributet e secilit anëtar të jepen me shkrim në formë zyrtare ose nëpërmjet postës elektronike.
7. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore të raportojë mbi ecurinë e procesit në mënyrë periodike, në çdo mbledhje të radhës të Këshillit Kombëtar të Ujit.
8. Projektplanin e menaxhimit të rrezikut nga përmblytjet të hartohet brenda muajit qershor 2022.
9. Drejtuesit e institucioneve të përmendura në pikën 3, të këtij urdhri, të dërgojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, emrat e përfaqësuesve të tyre pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.
10. Anëtarët e emëruar kanë përgjegjësi personale për pjesëmarrjen, prezencën dhe kontributin në fushën që përfaqësojnë. Zëvendësimi i tyre të bëhet me shkresë të drejtuesit të institucionit.
11. Përfaqësuesit e institucioneve të kenë mbështetjen e plotë të institucionit që përfaqësojnë për të siguruar informacionin dhe kontributin e nevojshëm në cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara.
12. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit ndërinstitucional të punës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dërgimi i emrave të përfaqësuesve nga institucionet e përmendura në pikën 3, të këtij urdhri.
13. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Instituti i

Shëndetit Publik, Instituti i Statistikave, Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë, Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër, Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Shkodër, Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

KRYEMINISTRI

EDL RAMA

NR.PROT. 3580/1
DATË 13.9. 2021

AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE
UJORE
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL
MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE
AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË
TERRITORIT
AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR
AGJENCISË KOMBËTARE TË UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË
MBETJEVE
AGJENCISË KOMBËTARE TË PYJEVE
AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT
SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR
INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK
INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
ZYRËS SË ADMINISTRIMIT TË BASENIT UJOR
DRIN-BUNË
PREFEKTIT TË QARKUT TË SHKODRËS
ADMINISTRATËS RAJONALE TË ZONA VE TË
MBROJTURA, SHKODËR
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

